



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1113

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim- Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit te QKMF Drenas” me numër të prokurimit 206-25-8016-2-3-6, me 26/12/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K., me nr. 2025/1113, e datës 10/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit te QKMF Drenas” me numër të prokurimit 206-25-8016-2-3-6.
2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit te QKMF Drenas” me numër të prokurimit 206-25-8016-2-3-6 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsvetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.09.2025 MINISTERIA E SHËNDETËSISË., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit të QKMF Drenas” me numër të prokurimit 206-25-8016-2-3-6.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 9,999.00 €.

Me 24.09.2025 MINISTERIA E SHËNDETËSISË., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti e prokurimit.

Me 27.10.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 30.10.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.11.2025, OE GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokollit 2025/1113, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ne si Grup i Operatorëve Ekonomik GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K; STUDIO HAPSIRA SH.P.K, më datë 09.09.2025 kemi dorëzuar ofertën tonë për aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i Ekspertizës Profesionale Inxhinierike për Vlerësimin e Projektit të QKMF Drenas”, ndërsa më datë 24.09.2025 Autoriteti Kontraktues më datën 02.10.2025 aprovon kërkesën për rishqyrtim të datës 29.09.2025, ndërsa në mënyrë kontradiktore për pretendime të njëjta me datën 22.10.2025 merr vendim për eliminimin tonë në mënyrë absurde për pretendime të cilat nuk janë specifikuar në dosjen e tenderit as në njoftimin për kontratë.

Provë:

- Po e bashkëngjesim Vendimin e Autoritetit Kontraktues “Njoftim aprovimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 29.09.2025”.

- Po e bashkëngjesim Vendimin e Autoritetit Kontraktues “Njoftim lidhur me vendimin për eliminimin tonë 22.10.2025”.

PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimi 1: Nuk keni kontrata në fushën e kërkuar

Bazuar në listën e prezantuar të kontratave në 3 vitet e fundit, ne kemi markuar me ngjyrë të verdhë dhe kemi specifikuar se cilat kontrata i kemi realizuar sipas natyrës së FDT-së. Në rastin konkret vendimi mbi eliminimin tonë është absurd, pasi pikërisht në këtë institucion kemi kryer shërbime të ngjashme sipas listës së prezantuar më lartë të markuar me ngjyrë të verdhë, të bashkëngjitur me kontratë, certifikatë pranimi të punëve dhe pagesave, si dhe faturat e protokoluara. Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59.

Provë:

Në kuadër të listës kemi dorëzuar projektin me certifikatën e pranimit “Ndërtimi i kulmit dhe renovimi i objektit ekzistues të Qendrës Spitalore në Biti të Poshtme, Komuna Shtërpcë”, e cila është lëshuar më datën 27.11.2023 dhe është brenda 3 viteve nga njoftimi për kontratë dhe plotëson kërkesat e përshtatshmërisë së FDT-së.

Në kuadër të projektit janë përfshirë situacioni i ngushtë dhe gjerë gjeodezik, faza e arkitekturës, elektrikës, instalimet hidroteknike, si dhe të gjitha fazat e përmendura në pretendimin lidhur me eliminimin tonë, të bashkëngjitura në dokumentin në vijim.

Me qenëse këto analiza nuk janë specifikuar tek kërkesa e përshtatshmërisë profesionale, Neni III.4 i FDT-së, konsiderojmë që pretendimi ndaj eliminimit tonë është kontradiktor: njëherë pranohet kërkesa për rishqyrtim, pastaj refuzohet për pretendime të njëjta, ku mundohet të jepen sqarime dhe justifikime të cilat nuk kanë qenë të precizuara në dosjen e tenderit.

Rregullorja 0021/2022 për Prokurim Publik, AK i ka ikur një kriteri të tillë. Përfundimisht, kjo mënyrë e eliminimit të aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe tejet arbitrare dhe si e tillë duhet të parandalohet nga OSHP si organ më i lartë vendimmarrës.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë të pabazuara, duke marrë parasysh arsyet e eliminimit të cekura në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 22.10.2025, të dhëna nga Komisioni Vlerësues në procesin e rivlerësimit të aktivitetit, si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Marrë parasysh ndjeshmërinë e punës, e cila duhet të kryhet nga operatori ekonomik i përzgjedhur në këtë procedurë të prokurimit, punë që kërkon analiza të detajuara profesionale, si:

- Analizimin e plotë të situacionit të ngushtë dhe të gjerë në parcelë dhe pozicionimin e objektit në lokacion;
- Analizimin e aspektit gjeodezik me të gjitha elaboratet përkatëse;

- Analizimin e arkitekturës dhe funksionalitetit të objektit;
- Analizimin e strukturës (statikës) së objektit në projekt, përfshirë edhe hartimin e elaboratit sipas nevojës;
- Analizimin e instalimeve elektrike (përfshirë tensionin e ulët), hidro-instalimeve dhe instalimeve të makinerisë;
- Si dhe përgatitjen e një raporti të plotë me detaje dhe pjesën grafike për secilën analizë.

Pas rivlerësimit të ofertës së grupit të GOE “GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K.” dhe “STUDIO HAPSIRA SH.P.K.”, Komisioni Vlerësues ka konstatuar sa vijon:

Projektet e paraqitura nga operatori, të cilat përfshijnë projekte të renovimit, nuk mund të llogariten si projekte të ngjashme me natyrën e këtij projekti, i cili kërkon ekspertizë profesionale për vlerësimin e dokumentacionit teknik, përfshirë specifikimet teknike, paramasat dhe parallogaritë, pjesën grafike dhe elaboratet përcjellëse në të gjitha fazat e projektit.

Në referencën e kontratës me Komunën e Prishtinës (nr. 616-20-8590-2-2-1), data e lëshimit të referencës nuk përputhet me datën e kërkesës për lëshim të referencës. Referenca është e datës 13.01.2025 ndërsa kërkesa për referencë është e datës 10.05.2025.

Po ashtu, dokumenti “Referencë” është lëshuar përmes Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, por mungon nënshkrimi nga zyrtari përgjegjës i kësaj drejtorie. Forma e referencës nuk është e pranueshme për AK, meqenëse është hartuar si shkresë MEMO, është dashtë të jetë e aprovuar nga zyrtari përgjegjës si dhe të jetë me protokoll të institucionit.

Në kontratën “Hartimi i dokumentacionit teknik të detajuar – projekte të detajuara”, referenca e lëshuar nga menaxheri i kontratës përfshin disa projekte, ndër to edhe “Renovimi i objektit ekzistues të Qendrës Spitalore në Biti të Poshtme”.

Sipas listës së projekteve të realizuara të paraqitur nga operatori ekonomik, realizimi i kësaj kontrate fillon më datën 03.06.2022 dhe nuk ka përfunduar, ka statusin “Vazhdon”. Kontrata në listë është me vlerën 120,000.00 € (nga të cilat deri më tani rreth 63,000.00 € janë të realizuara).

Bazuar në këtë, rezulton se kontrata nuk është përfunduar dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si kontratë e përfunduar me sukses, sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Projekti me titull “Renovimi i objektit ekzistues të Qendrës Spitalore në Biti të Poshtme”, si pjesë e kontratës kornizë, nuk është projekt i natyrës së ngjashme sikurse është projekti për ndërtimin e QKMF në Drenas, por është një projekt për renovim të kulmit dhe disa renovime të brendshme në objektin në Biti të Poshtme.

Në referencat e Komunës së Hanit të Elezit, njëra (dt. 30.11.2022) për kontratën kornizë “Hartimi i projekteve detale” nuk specifikon emrin e projektit, por vetëm përmend “projektet e lartcekura”, ndërsa referenca tjetër i referohet rregullimit të mureve mbrojtëse dhe shtrimit të kubëzave, që nuk janë të ngjashme me llojin e kërkuar të projektit.

Gjithashtu, kontratat tjera të paraqitura me statusin “në vazhdim” apo kontratat kornizë të papërfunduara nuk janë të pranueshme si përvojë relevante.

Juve u mungon projekti i ngjashëm me sektorin e shëndetësisë, siç kërkohet në dosjen e tenderit (projekt i kryer në QKMF, objekt spitalor apo klinikë), ndërsa nuk pranohet projektimi i Depos së Barnave, as projektimi i Mbistrehës në QKMF dhe Garageve në QKMF dhe objekte tjera.

Duke u bazuar në të gjitha këto gjetje, komisioni konstaton se operatori ekonomik nuk i plotëson kriteret e përvojës profesionale dhe teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe, për këtë arsye, rekomandon që oferta e grupit të operatorëve ekonomik “GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K.” dhe “STUDIO HAPSIRA SH.P.K.” të klasifikohet si e papërgjegjshme.

Sa i përket aprovimit të kërkesës paraprake për rishqyrtim të datës 29.09.2025, kjo dëshmon vullnetin tonë të mirë, me ç’rast lëndën e kemi kthyer në rivlerësim, por komisioni vlerësues nuk e ka pranuar ofertën tuaj si të përgjegjshme.

Ne jemi të vetëdijshëm për projektet e juaja që i keni hartuar për MSH, por ato projekte janë për renovime në ISSH dhe renovim të Depos së Barnave, dhe nuk janë të kategorisë së kërkuar “objekt spitalor apo klinikë”.

Edhe projekti me Komunën e Prishtinës është për mbistrehë dhe garazha të QKMF-së, nuk është i kategorisë së kërkuar “QKMF, objekt spitalor apo klinikë”.

I vetmi projekt që është marrë në shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues ka qenë projekti i quajtur “Renovimi i objektit ekzistues të Qendrës Spitalore në Biti të Poshtme”. Në këtë objekt janë bërë disa renovime sipërfaqësore, ndërrim kulmi dhe disa renovime të brendshme, me ç’rast nuk është projekt bindës për kategorinë e kërkuar “QKMF, objekt spitalor apo klinikë”.

Projekti emërtimin e ka si Qendër Spitalore në Biti të Poshtme, ndërsa si objekt është i kategorisë së QMF-së. Gjithashtu, sipas njoftimit nga MSH, ky objekt shëndetësor nuk është pjesë e sistemit shëndetësor të Kosovës (si duket i takon sistemit paralel serb).

Oferta juaj është refuzuar si e papërgjegjshme meqenëse nuk keni dëshmuar eksperiencën e juaj në projekte të ngjashme siç është kërkuar. Objekti i MSH-së – Ndërtimi i QKMF në Drenas është projekt 3 milionësh ndërtim i ri dhe kërkohet ekspertizë profesionale për shqyrtimin inxhinierik të gjithë projektit me të gjitha fazat inxhinierike, urbanistike dhe administrative, meqenëse janë krijuar probleme në fillim të implementimit dhe konteste në mes palëve të kyçura në ekzekutim të projektit.

Kontrata me KK Shtërpçë ende është në vazhdim, ndërsa kriteri ka qenë për kontrata të përfunduara:

Kërkesa 1. OE duhet të dëshmojë përvojë profesionale (projektim ose revidim) në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë në vlerë prej 15,000.00 Euro. Të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë (QKMF, objekt spitalor apo klinikë).

Gjithashtu në kriter është potencuar “...së paku hyrbi ngjashëm (projektim ose revidim)...”, që nënkuptohet me natyrën e këtij aktiviteti, e që ju nuk e keni dëshmuar.

Arsye shtesë: AK–MSH është në proces të kontraktimit për shërbime të veçanta të dy inxhinierëve (një arkitekt dhe një ndërtimtar konstruktiv), me aktivitetin e prokurimit për 36 muaj me titull “Kontraktimi i shërbimeve të veçanta inxhinierike” me nr. prokurimi 206-25-9212-2-2-1, dhe për hapat e mëtejme presim angazhimin profesional të këtyre inxhinierëve, si

dhe të inxhinierëve shtesë nga institucionet tjera qendrore, për zgjidhjen e çështjes së këtij projekti me stafin e institucioneve dhe pa angazhim të kompanive fare.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1113, ndërsa me datë 21.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1113, me rekomandimet si në Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1113 ka vlerësuar si në vijim:

Operatori ekonomik ankues ka paraqitur arsyet lidhur me anulimin e procedurës nga autoriteti kontraktues, përkatësisht arsyet e eliminimit në letrën standarde duke ofruar informacion dhe dëshmi se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me nenet përkatëse të paraqitura në ankesë.

Autoriteti Kontraktues, pas kërkesës për rishqyrtim e ka pranuar kërkesën për rishqyrtim sit ë bazuar të datës 02.10.2025.

Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues me date: 22.10.2025 merr vendim për anulimin e procedurës përkatësisht jep edhe arsyet për eliminimin e ofertës të grupit të operatorëve ekonomik ankues.

Arsyet e eliminimit të ofertës të grupit të operatorëve ekonomik ankues janë s inë vazhdim:

Sic mund të shihet autoriteti kontraktues në arsyet e eliminimit ka sqaruar se kontratat e paraqitura nga GOE nuk janë projekte të ngjajshme me natyrën e projektit të kërkuar nga autoriteti kontraktues.

Gjatë analizimit të dëshmive të ofruara nga operatori ekonomik ankues në ofertën e tij dhe analizimit të kontratave të realizuara përkatësisht kontratës me titull: Ndërtimi I kulmit dhe renovimi i objektit egzistues të qendrës spitalore në biti të poshtme dhe me numër 02-030/01-

6402/23, kontrata e datës: 15.03.2023, në pozicionet përkatëse si në vazdhim janë pothuajse të njëjta me ato të arsyeve të dhëna në letrën standarde për eliminim:

Andaj duke u bazuar në arsyet dhe dëshmitë e ofruara poashtu referuar nenit 1,7, dhe 59 të LPP-së , referuar opinionit të KRPP-së lidhur me sqarimin për natyrën e kontratave të njëjta dhe të ngjajshme si në vazdhim, dhe kërkesës së autoritetit kontraktues se kontratat e realizuara duhet të jenë në kuptimin e kontratave të realizuara si të“ngjajshme” vlerësoj se ankesa e grupit të operatorit ekonomik ankues është e bazuar.

OPINIONI I KRPP:

11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme” në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION

Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Në kuptim të prokurimit publik:

Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi “të ngjashme” ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës “Furnizim me mollë”. Nëse AK kërkon si dëshmi ” Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro”. Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatorët ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).

Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshtet si në vijim: “Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara.....” Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet “të njëjta” apo “të ngjashme”.

Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e

kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: “Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?”, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

PËRFUNDIM:

Në bazë të arsyeve të dhëna dhe dëshmive të ofruara vlerësoj se ankesa e GOE ankues është e bazuar, andaj të bëhet anulimi i njoftimit për anulimin e procedurës dhe lënda të kthehet në rivlerësim;

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit të QKMF Drenas” me numër të prokurimit 206-25-8016-2-3-6.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar sikurse kërkohet në dispozitat e LPP-se konkretisht nëneni 113 dhe 114 i LPP-së dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet B58Njoftimi mbi vendimin e AK-se , dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: